



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 753/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e Doruntinë Maloku Kastrati, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.753/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Doruntinë Maloku Kastrati, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në të gjitha vendvotimet në Komunën e Podujevës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.753/2021 nga Doruntinë Maloku Kastrati, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se sipas informatave të vëzhguesve të LDK-së dhe të OJQ-së ORFEU në disa vendvotime ku ata kanë qenë, kanë parë që është tentuar të manipulohen votat e saj si kandidate për deputete dhe kërkon nga PZAP që të rinumërohen të gjitha vendë votimet në Komunën e Podujevës, sipas pretendimeve të palës ankuese organizata ORFEU ka raportuar qasje të kufizuar gjatë numrimit të votave të kandidateve për deputet, me tutje pretendon se në shumicën e vendvotimeve vëzhguesit e kesaj organizate kanë pasur qasje të kufizuar gjatë numrimit të votave të kandidateve për deputet të subjekteve politike, dhe se rezultatet e raportuara nga vëzhguesit e kesaj organizate nuk përputhen me shpalljen e rezultateve nga KQZ. Andaj kërkon nga PZAP që të rinumërohen të gjitha vendvotimet në Komunën e Podujevës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Doruntinë Maloku Kastrati, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.752/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të gjitha vendvotimet në Komunën e Podujevës.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.753/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Doruntinë Maloku Kastrati, kandidatë për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, gjegjësisht ankueses ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Gjithashtu ankuesja në apel nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi-vendvotim ku pretendon se është bërë gabim në bartjen e rezultateve për kandidat, apo ku është dëmtuar sa i përket votave të numëruara. Siç thuhet në pretendimet ankimore se vëzhguesit e OJQ-së ORFEU, nuk kanë pasur qasje, gjegjësisht se kanë pasur qasje të kufizuara gjatë numërimit, këtë pretendim të ankueses Paneli nuk e konsideroj të provuar pasi që nga vet përmbajtja e apelit del si pretendim kontradiktor, pasi ankuesja më tutje thekson se rezultatet e raportuara të OJQ-së ORFEU, nuk përputhen me rezultatet e shpallura. Në rastin konkret paneli vlerëson se një pretendim i tillë i përgjithësuar është tërësisht i pa bazuar dhe i pa argumentuar, për faktin se pala ankues nuk ka ofruar asnjë dëshmi, qoftë ndonjë formular apo provë tjetër që do të bënte apelin të bazuar, andaj mbi një gjendje të tillë të fakteve paneli e refuzoi apelin në tërësi si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtuar nga Doruntinë Maloku Kastrati e subjektit politik LDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 753/2021 më datën 06.03.2021

Kryesues i Panelit
Zyhdi Haziri

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*